



# Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

## DEKLARATA E FORUMIT RAJONAL TË FEMINISTEVE TË REJA

Ne, femistet e reja, besojmë në barazi gjinore dhe i dimë të drejtat tona që parashesh kushtetuta dhe ligjet e Kosovës. Nëpërmjet kësaj deklarate ne shprehim rekomandimet tek institucionet e Kosovës për të siguruar të drejtat tona.

### **Të zbatohet kuota 30% për përfshirjen e grave dhe burrave në procese vendim-marrëse**

Ligji për Barazi Gjinore thotë se duhet të ketë mundësi të barabarta për pjesëmarrje të grave dhe burrave. Kjo arrihet në rastet kur pjesëmarrja e një gjinie në institucione, organe dhe në nivele të pushtetit është 40%.<sup>1</sup>

Grave i është mohuar e drejta nga ky ligj. Ne bëjmë thirrje për zbatim të menjëhershëm të këtij ligji, i cili do të krijojë një bazë për ne dhe vajzat tjera të kenë role udhëheqëse në shtetin tonë në të ardhmen. Prandaj, ne kërkojmë nga Presidentja e Republikës së Kosovës Znj. Atifete Jahjaga, Kryeministri i Republikës së Kosovës, Z. Hashim Thaçi dhe Agjensioni për Barazi Gjinore, të përdorin kompetencat e tyre për të bërë presion për zbatimin e ligjit drejt sigurimit të të drejtave të grave për përfshirje në procese vendim-marrëse.

### **Të zbatohet ligji për arsim parauniversitar**

"Kur e edukon një grua e edukon një brez të tërë," thotë Brigham Young. Ligji për Arsimin Parauniversitar detyron prindërit që të sigurojnë përfundimin e shkollimit të detyruar për fëmijët e tyre.<sup>2</sup> Edhe pse prindërve i ndalohet me ligj, nga eksperiencia jonë personale shumë fëmijë, në veçanti vajzat, ende e braktisin shkollën nga presioni i familjes ose si rezultat i martesave të hershme. Edhe sot, nuk janë ndërmarrë hapa për zbatimin e këtij ligji.

Ne kërkojmë nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) të marrin masa të menjëhershme dhe të trajtohet me më seriozitet zbatimi i ligjit. Inspektorët për arsim duhet të gjobisin prindërit të cilët nuk sigurojnë përfundimin e shkollimit të detyruar për fëmijët e tyre. Kjo do të ndikonte që të gjithë fëmijët të sigurojnë të drejtën për arsimim.

### **Të sigurohen transporti dhe librat për të gjithë studentët e arsimit të detyruar**

Ligji për Arsim Parauniversitar parasheh që çdo fëmijë që jeton larg nga shkolla duhet të ketë të siguruar transportin me ose pa pagesë nga komuna.<sup>3</sup> Edhe sot, për arsye të papunësisë dhe gjendjes jo të mirë financiare, nga eksperiencia jonë ekzistojnë shumë familje të cilat nuk kanë mundësi të paguajnë transportin dhe librat për të gjithë fëmijët në mënyrë që të përfundojnë shkollimin e detyruar. Prandaj, vajzave në veçanti ju ndalohet e drejta për arsimim pasi që kushtet financiare të familjes nuk e lejojnë.

Qeveria ka përgjegjësi të sigurojë që transporti dhe librat të mundësohen për të gjithë fëmijët në mënyrë që ata të përfundojnë arsimin parauniversitar, që është e drejtë e tyre. Ne kërkojmë nga MASHT, Ministria e Financave dhe Parlamenti i Republikës së Kosovës, të aprovohet një buxhet i mjetufueshëm për të mbuluar transportin dhe librat për të gjithë studentët. Ne mendojmë që është një prioritet jo vetëm për edukimin e vajzave por për zhvillimin afatgjatë të Kosovës.

<sup>1</sup> Neni 3 pika 3.1.

<sup>2</sup> Neni 15, pika 2.1

<sup>3</sup> Neni 15, pika 5

### **Të përfshihen psikologët në shkolla**

Duke ditur se një ndër synimet kryesore të Kosovës është anëtarësimi në Bashkimin Europian, MASHT duhet t'i plotësojë kriteret europiane për edukim kualitativ ku përfshihet edhe punësimi i kadrove profesionale si psikologët dhe punëtorët social. Kosova udhëheq në rajon me numrin më të madh të nxënësve që braktisin shkollën<sup>4</sup>. Bazuar në strategjinë e arsimit në Kosovë për vitin 2011-2016, psikologët cilësohen të nevojshëm vetëm për ndërtimin e rrjeteve mbrojtëse shkollore. Gjithashtu bazuar në udhëzimin administrativ të nxjerrur nga MASHT në vitin 2013<sup>5</sup> thuhet se shkolla duhet të ketë mbi 1000 nxënës në mënyrë që të ketë një psikolog.

Ne vlerësojmë se gjendja në Kosovë është alarmante. Besojmë që prania e psikologëve dhe punëtorëve social në shkolla mund të parandalonte braktisjen e arsimit nga studentet, si dhe mund të ofrojnë këshillime për ato. Prandaj, ne rekomandojmë që psikologët të ushtrorjnë detyrat e tyre parësore të cilat konsistojnë në zhvillim mendor dhe fizik të nxënësve. Ne gjithashtu rekomandojmë që secila shkollë të ketë psikologun e saj pa marrë parasysh numrin e nxënësve.

### **Të zbatohet Kodit Etik për mediat e shkruara dhe ato elektronike**

Gazetaria kosovare duhet të mbërthejë në vete principet e barazise gjinore, duke filluar që nga mënyra se si paraqiten dhe përshkruhen vajzat dhe gratë në mediat tona. Gjuha degraduese dhe raportimi jo-etik mbi vajza dhe gra ka efekte negative në besimin e opinionit të gjërë në media. Për më shumë, ato përforcojnë stereotipe shoqërore mbi rolet gjinore.

Ne kërkojmë nga Komisioni i Pavarur për Media, përgjegjës për mediat elektronike, dhe Këshilli i Mediave të Shkruara, përgjegjëse për gazetatat e shtypura dhe ato online, të shtyjnë tutje denimet atëherë kur mediat e shkruara dhe ato elektronike shkelin kodin etik nëpërmjet raportimit jo-etik mbi vajza dhe gra.

Prishtinë, Kosovë  
13, 14 nëntor 2013

---

<sup>4</sup> Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në bashkëpunim me UNICEF-in, *Shkrim lexim bazik për gra dhe vajza*, Prishtinë

<sup>5</sup> Udhëzim administrativ: Nr. 26/2013, Zgjedhja e nënpunësve për Ofrimin e Shërbimeve Profesionale në Institucionet Edukative-Arsimore Parauniversitare, Neni 4